



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3901 Prot

Shkodër, më 07.03.2021

VENDIM

Nr. 82 datë 07/03/2021

PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË ANKANDIT PUBLIK ME OBJEKT " SHITJE ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT VLLAZNIA", SH.A NË MASËN 100%.

Në mbështetje të nenit 8, të ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; nenit 42, pika 7 të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008" Për ankandin Publik", të ndryshuar, VKM 1719, datë 17.12.2008 " Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar , shkresës së administruar në bashkinë Shkodër nr.3878, datë 05.03.2021, me lëndë "Formulari i ankesës", drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, për dijeni bashkisë Shkodër ,

VENDOSA :

1. Të pezullohet procedura e Ankandit Publik me objekt " Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia", sh.a në masën 100%, deri në shqyrtimin përfundimtar të ankesës nr.3878, datë 05.03.2021, nga Komisioni i Prokurimit Publik.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Ankandit .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Voltana Ademi

